



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.07/2021

**Bordi për Ankesa**, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2103/295/KPM/n.r të datës 04.03.2021 të parashtruesit “Shell Brands International AG, Baarematter, CH-6340, Zvicër, me përfaqësueset ligjore Kujtesa Nezaj Shehu dhe Florentina Grubi Vula, kanë paraqitur Ankesë ndaj Vendimit Ref:2102/082/KPM/xhl, të datës 28.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pa bazuar Ankesa Ref:2103/295/KPM/n.r e datës 04.03.2021 e parashtruesit “Shell Brands International AG, Baarematter, CH-6340, Zvicër” me përfaqësueset ligjore Kujtesa Nezaj Shehu dhe Florentina Grubi Vula dhe mbetet në fuqi Vendimi Ref:2102/082/KPM/xhl, i datës 28.01.2021 i Komisionit të Pavarur të Mediave.

### A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/082/KPM/xhl, të datës 28.01.2021 e ka refuzuar ankesën si të pa bazuar të “Shell Brands International AG, Baarematter, CH-6340, Zvicër” përmes të cilës pretendohet se Radio Kosova 1 dhe Glam Radio kanë vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 5.1 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale Audiovizuale.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “Shell Brands International AG, Baarematter, CH-6340, Zvicër”, me përfaqësueset ligjore Kujtesa Nezaj Shehu dhe Florentina Grubi Vula ka parashtruar Ankesë Ref:2103/295/KPM/n.r me datën 04.03.2021 pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: shkeljeve procedurale dhe aplikimit të gabueshëm të ligjit material dhe propozon BA që të aprovohet Ankesa si dhe Vendimin Ref:2102/082/KPM/xhl ta ndryshojë, ashtu që të aprovohet Ankesa në tërësi si e bazuar.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Shell Brands International AG, Baarematter, CH-6340, Zvicër” si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e vendimit Ref:2102/082/KPM/xhl, të datës 28.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me shkeljet procedurale dhe aplikimin e gabuar të ligjit material nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara sepse Komisioni i Pavarur të Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike dhe analizuar gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe nuk kemi të bëjmë me shkelje procedurale. Ndërsa, sa i përket pretendimit për zbatimin e gabuar të drejtës materiale nuk qëndron, sepse KPM me Vendimin e saj ka analizuar gjitha shkresat e pranuar nga dy palët dhe ka gjetur se informacioni i dhënë në komunikimin komercial të cilin janë duke e transmetuar Radio Kosova 1 dhe Glam Radio është i mbështetur në fakte.


Bordi për Ankesa konstatoi që Vendimi i KPM-së është marrë duke u bazuar në dispozitat materiale, përkatësisht në pajtim me nenin 6 paragrafi 5.1 të Rregullores KPM-2017/07 si dhe dispozitat procedurale.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij Vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativenë afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:  
-Palëve dhe  
-Arkivit të KPM-së.



Ylber Fetahaj  
  
Kryetar i Bordit për Ankesa